




Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Referenca : 626/19/021/5-2-1

Në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Rregullave dhe udhëzuesit të Prokurimit Publik dhe në bazë të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave të rregullores së Prokurimit Publik neni 4 paragrafi 4.1 neni 7 paragrafi 7.1 a), dhe neni 8 paragrafi 8.1 bie këtë :

V E N D I M

I

Refuzohet si e pa bazë Kërkesa për Rishqyrtim e Operatorit Ekonomik “Ekotermika” SH.P.K nga Suhareka e parashtruar me datën 31.07.2019 për aktivitetin e prokurimit me nr. 626-19-3965-5-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-19-021-5-2-1 me titull: “Ndërrimi i sistemit të ngrohjes qendrore furnizimi dhe riparimi i klimave për administratën në Komunën e Mamushës “

II

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik “Ekotermika” SH.P.K nga Suhareka me datë 31.07.2019 ka paraqitur Kërkesën për rishqyrtim përmes platformës elektronike të prokurimit.

Si Autoritet Kontraktues brenda afatit ligjor, kemi filluar shqyrtimin e kërkesës në fjalë nga e cila kemi vërejtur se Operatori Ekonomik e ka keqkuptuar shkresën tonë të datës 30.07.2019 me të cilën e kemi njoftuar për gabimet aritmetikore të cilat i ka gjetur komisioni i vlerësimit gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit në fjalë.

Në shkresë kemi cekur se Operatorit Ekonomik ka bërë gabim aritmetik si vijon: në pjesën 2 (dy) tek pozicioni me numër rendor 10 (dhjet), shuma e dhënë nga ana O.E është kalkuluar si në vijim $2.00 \times 78 = 78.00$ euro, ndërsa komisioni ka konstatuar se çmimi i pjesës 2 (dy) të tenderit në

pozicionin 10 është $2.00 \times 78 = 156.00$ euro. Gjithashtu në pjesën 2 (dy) tek pozicioni me numër rendor 18 (tetëmbëdhjetë) .Shuma e dhënë nga ana O.E është kalkuluar si në vijim $10.00 \times 4.47 = 22.35$ euro, ndërsa komisioni ka konstatuar se çmimi i pjesës 2 (dy) të tenderit ne pozicionin 18 është $10.00 \times 4.47 = 44.70$ euro. Prandaj vlera e përgjithshme e tenderit të O.E 14.444,44 euro, sa ka qen në hapje të tenderit ka ndryshuar në 14.466,79 euro, e cila duke u kthyer në përqindje del **0.15%** e vlerës së ofertës.

Pra sikur shihet në sqarimin tonë ne nuk kemi cekur në asnjë pikë se Operatori Ekonomik ankues e ka tejkuluar gabimin aritmetik më tepër se 2% të përcaktuar me LPP sikur ka pretenduar O.E.

Operatori Ekonomik pas pranimit të kërkesës tonë për sqarim ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim me pretendimin se është shkelë neni 59 i LPP-s sepse sipas këtij neni është i lejuar gabimi aritmetik deri në vlerën 2% të ofertës.

Për procedurën në fjalë, ende nuk është marrë vendimi i autoritetit kontraktues, si dhe nuk i kemi dërguar operatorit ekonomik ankues letër për eliminim sikur e ka keqkuptuar ky O.E. por kemi kërkuar sqarim si dhe kemi cekur se nëse **nuk** pajtohen me këtë (këto) amendament(e), ju lutem të na kontaktoni menjëherë **me shkrim** në adresën e lartë shënuar të autoritetit kontraktues apo në e-mail.

Duke u bazuar në legjislacionin e cekur në pjesën hyrëse të këtij vendimi, dhe në provat shkresore është konstatuar se kërkesa për rishqyrtim e O.E. "Ekotermika" SH.P.K është e pa bazuar.

Andaj,

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë, pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me 01.08.2019

Në M a m u s h ë

Gazmend Gashi
Udhëheqës i sektorit të Prokurimit
Komuna e Mamushës



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtrojë ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues.